

# FONDACIONI Freskia

Zyrat tona:

Zyra qendrore e Fondacionit Freskia është në Prishtinë.

Adresa: Rr. Shaban Polluzha, Nr. 10.

Kontakti:

Mob:

+383 45 212-600

+383 45 100-231

E-Mail:

[fondacioni.freskia@gmail.com](mailto:fondacioni.freskia@gmail.com)

Ueb:

[www.fondacionifreskia.org](http://www.fondacionifreskia.org)

Facebook:

@FondacioniFreskia

Bank Details:

BANK NAME: Nib bank

SWIFT CODE: NLPR XK PR

IBAN: XK051701001600074675

BENEFICIARY NAME: FONDACIONI FRESKIA



FONDACIONI  
Freskia

# Dhurata e Bajramit

045 212 600 [www.fondacionifreskia.org](http://www.fondacionifreskia.org) SWIFT CODE: NLPR XK PR  
IBAN CODE: XK051701001600074675



## Dhurata e Bajramit

<b>Emir i projektit</b>	<b>Dhurata e Bajramit</b>
<b>Kategoria</b>	Mirëqenie sociale
<b>Përshkrimi</b>	Sigurimi i Dhuratës së Bajramit që nënkupton ushqime, veshmbathje, dhe lodra për fëmijë skamnore, fëmijë nën asistencë sociale dhe fëmijë jetim. Dhuratë kjo që do t'u dërgohet fëmijëve me anë të postës në mënyrë që të mos lëndohen emocionalisht në prag të festave të bajrameve
<b>Arsyeshmëria e projektit</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kushtet e rënda ekonomike bëjnë shumë familje që të mos e ndejnë festën dhe shumë fëmijë që të jenë të privuar nga gëzimi i këtyre festave.</li><li>- Mungesa e mbështetjes dhe përkrahjes institucionale për një kategori të tillë.</li><li>- Shkalla e lartë e varfërisë në shoqëri.</li></ul>
<b>Synimet</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Sigurimi i Dhuratës së Bajramit që nënkupton ushqime, veshmbathje, dhe lodra për fëmijë skamnore, fëmijë nën asistencë sociale dhe fëmijë jetim. Dhuratë kjo që do t'u dërgohet fëmijëve me anë të postës në mënyrë që të mos lëndohen emocionalisht në prag të festave të bajrameve.</li><li>- Angazhimi në kultivimin e shpirtit të bamirësisë në mesin e njerëzve.</li><li>- Sjellja e lumturisë tek familjet e varfra.</li><li>- Huluntimi i rrugëve të mirësisë dhe përhapja e saj në mesin e shoqërisë.</li></ul>
<b>Premisat e suksesit</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Përvoja e ekipit realizues në fushën përkatëse.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritshme</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Sigurimi i dhuratës së Bajramit që do ndikojë në kthimin e buzëqeshjes për fëmijët.</li><li>- Thellimi i raporteve ndërmjet shtresave të shoqërisë.</li><li>- Rritja e nivelit të bamirësisë në shoqëri dhe përmirësimi i gjendjes sociale.</li><li>- Futja e lumturisë tek fëmijët në nevojë.</li></ul>
<b>Shtresat përfituese</b>	Familjet skamnore, familjet nën asistencë sociale dhe familjet me fëmijë jetim
<b>Periudha e realizimit</b>	Festat e Bajrameve
<b>Numri i përfituesve</b>	200 fëmijë
<b>Kostoja e projektit</b>	12000€ (200 X 30€ x 2herë gjatë vitit = 12000€)
<b>Ekipi realizues</b>	<b>Fondacioni Freskia</b>



*“Një kokërr gruri nuk e mbush dot hambarin,  
por ndihmon kokrrat e tjera për ta mbushur”.*  
**Sami Frashri**

### Kush jemi ne...

E ngritur mbi parimet bazike humanizmit, solidarizimit dhe shërbimit ndaj të gjithëve, **“Fondacioni Freskia”** është (N.G.O) kosovare.

U themeluar në vitin 2015, dhe u regjistrua në përputhje me ligjet për O.J.Q-të e Republikës së Kosovës. Mbanë nr. të regjistrimit: **5200337-7**.

Fondacioni drejtohet nga një grup aktivistësh vullnetarë, që si vizion dhe preokupim kanë mirëqenien e shoqërisë kosovare.

Mbështetjen kryesore e ka nga Institucionet dhe donatorët vendorë, por një mbështetje e tillë nuk mungon as nga mërgata jonë mbarë shqiptare.

### **Vizioni:**

Fondacioni Freskia vepron me një vizion shumë të qartë.

Është një derë e hapur për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallime etnike, fetare, gjinore apo racore.

Fondacioni Freskia mëton gjetjen e mënyrave adekuate për përmirësimin e gjendjes sociale të kategorive me nevoja të veçanta. Preokupimi ynë kryesorë është shkalla e lartë e papunësisë si dhe gjendja e rëndë socio-ekonomike, prandaj i tërë fokusi ynë është në përmirësimin e kësaj gjendjeje.

### **Misioni:**

Fondacioni Freskia është një fondacion vendor që synon shtresat më nevoja të veçanta dhe ato që janë në një gjendje të rënd socio-ekonomike.

Këtë mundohet që ta realizojë përmes implementimit të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme me karakter humanitar, vullnetarë dhe solidarizues me të tjerët. Misioni ynë parësorë është të qenit urë-lidhëse në mes të Institucioneve, Organeve gjegjëse, donatorëve, vullnetmirëve, dhe bamirësve nga njëra anë, si dhe nevojtarëve, skamnorëve, bonjakëve, të sëmurëve, dhe njerëzve me nevoja të veçanta nga ana tjetër. E tërë kjo synohet që të arrihet përmes metodave, praktikave dhe efikasitetit sa më të lartë.

### **Objektivat:**

Fondacioni Freskia synon të realizojë objektivat e saja si vijon:

- Ofrimi i strehimit dhe përmirësimi i kushteve të banimit.
- Mbështetje financiare dhe sociale për fëmijët jetim dhe familjarët e tyre.
- Mbështetje me ndihma periodike për familjet në nevojë.
- Ofrimi i mundësive për Nënata Vetushqyese dhe inkuadrimi sa më denjësisht në shoqëri.

Ndërsa për një mundësi sa më të mirë të realizimit të këtyre objektivave, në kuadër të Fondacionit Freskia veprojnë tre sektorë të ndryshëm:

- Sektori i Jetimëve
- Sektori i Gruas
- Sektori i ndihmave periodike

### **Projektet:**

Fondacioni Freskia tërë punën e saj e ka të mbështetur në projekte të ndryshme me karakter human. E që përmes implementimit dhe realizimit të këtyre projekteve mundohet që të realizojë edhe qëllimet e saja.

Projektet e Fondacionit Freskia janë të ndara në katër fusha kryesore:

-Mirëqenie sociale, ku bëjnë pjesë projekte si bursë për jetimët, çanta shkollore, kulm për të pastrehët, pakoja humanitare, kurbanet, etj.

-Përkujdes shëndetësorë, ku bëjnë pjesë projekte si vizita mjekësore, vizita familjare rehabilituese, sigurimi i barërave, etj.

-Aftësi profesionale, ku bëjnë pjesë projekte si kurse artizanale, kurse aftësuese, kurse përgatitore, etj.

-Ndihma periodike, ku bëjnë pjesë projekte si ofrimi i druve për ngrohje, ofrimi i veshmbathjeve, ofrimi i ndihmave emergjente në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, etj.